

“Mbi Zbatimin e Ligjit “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”

I nderuar z. Mullaj,

E nderuar znj. Karapanço,

Të nderuar pjesëmarrës,

Është kënaqësi për mua të jem sot në këtë aktivitetet dhe dua të falënderoj Dhomën Amerikane të Tregtisë për organizimin dhe interesin e shfaqur mbi ligjin e ri “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Duke qënë se në këtë sallë jemi me përfaqësues të nderuar të biznesit, dua ta nis fjalën time me një shprehje të J. P. Morgan:

“Shkoni aq larg sa mund të shihni; kur të arrini atje, do të jeni në gjendje të shihni më shumë”

Në formë simbolike, i tillë ka qënë pak a shumë edhe për ne rrugëtimi përmes të cilit ka kaluar ligji i ri për mbrojtjen e të dhënave personale.

Fillimisht, me hyrjen në fuqi në vitin 2018 të Rregullores së Përgjithshme të Bashkimit Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR), Shqipërisë i lindi detyra, por edhe ambicja për të hartuar një ligj të ri që do të ishte në përputhje me standardet dhe direktivat e BE-së, kjo edhe në kuadër të procesit të integritimit.

Ndërkohë që ishim në procesin e hartimit të ligjit, ekzistonin dilemat se sa larg do të shkonim me procesin e përafrimit, kjo edhe për faktin se Shqipëria është në një proces të avancuar dhe shumë intensiv të negociatave të anëtarësimit me BE-në, por ende në disa aspekte, edhe sa i përket nivelit ekonomik, nuk ka arritur tek standardet e BE-së.

Gjithsesi, në fund, pas një procesi të gjatë, ku patëm mbështetjen dhe asistencën e disa prej ekspertëve më të mirë të fushës nga vendet e BE-së, ne e finalizuam ligjin, i përputhur plotësisht me Rregulloren e BE-së dhe ai u miratua në 19 dhjetor 2024 nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Pra, tani, mund të themi se kemi arritur atje ku mund të shohim më shumë.

Megjithatë, sot kemi një tjetër sfidë apo një fazë të re, edhe kjo shumë e rëndësishme, që ka të bëjë me zbatimin e plotë të ligjit, për të cilin janë investuar shumë partnerët tanë, ekspertët ndërkombëtarë, si edhe shumë aktorë të tjerë dhe grupe interesi.

Në këtë kuadër, ky takim me ju, ashtu si edhe të tjerët që kemi zhvilluar, por edhe takimet e ardhshme që do të zhvillohen për këtë qëllim, marrin rëndësi të posaçme për të mbajtur një komunikim sa më të hapur me njëri-tjetrin, për të shpjeguar sa më mirë aspektet, risitë dhe detyrimet që lindin nga ky ligj për kontrolluesit dhe përpunuesit e të dhënave, të cilat ndihmojnë në zbatimin sa më të plotë të tij.

Ligji i ri 124/2024, sjell një sërë risish thelbësore në mbrojtjen e të dhënave personale të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë mbi bizneset në cilësinë e kontrolluesit apo përpunuesit.

Në zbatim të ligjit, Zyra e Komisionerit ka përgatitur aktet nënligjore, ku përfshihet gjithashtu metodologjia për përlllogaritjen e masës së sanksioneve administrative, të cilat ne i prezantuar edhe në procesin e konsultimit publik.

Në këtë kuadër, dua të falënderoj të gjithë ata përfaqësues të bizneseve, shoqatat, grupet e interesit që kanë përcjellë mendimet, shqetësimet apo propozimet e tyre pranë Zyrës së Komisionerit për të ndërmarrë përmirësime të mëtejshme të këtyre akteve.

Ligji i ri i siguron mbrojtje më të mirë për subjektet e mbrojtjes së të dhënave dhe gjithashtu përcakton më qartë të drejtat dhe detyrimet e çdo kontrolluesi dhe përpunuesi.

Ligji zgjeron të drejtat e individëve mbi të dhënat e tyre, duke përfshirë: Të drejtën për akses dhe përmirësim të të dhënave; të drejtën për të mos iu nënshtruar vendimeve automatike; si edhe të drejtën për t'u harruar, që detyron bizneset dhe platformat online të fshijnë të dhëna që nuk janë më të nevojshme për qëllimin për të cilin janë mbledhur.

Bizneset, ndër të tjera, duhet të marrin masa më të forta për të mbrojtur të dhënat personale kundër humbjes, aksesit të paautorizuar ose keqpërdorimit.

Kjo përfshin enkriptimin, kontrollet e qasjes, auditimet e rregullta dhe trajnimin e stafit për mbrojtjen e të dhënave.

Në këtë proces, ju do të asistoheni përmes trajnimeve edhe nga Zyra e Komisionerit.

Ligji i ri kërkon nga bizneset të caktojnë një Nënpunës për Mbrojtjen e të Dhënave (DPO), i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e përputhshmërisë me ligjin dhe për t'u siguruar që masat e duhura janë zbatuar.

Sa i takon kësaj të fundit Zyra e Komisionerit, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, do të ofrojnë trajnime dhe module për DPO-të për të ndihmuar në zbatimin e këtyre detyrimeve.

Përveç detyrimeve ligjore, është thelbësore që të gjithë ne të ndryshojmë qasjen ndaj mbrojtjes së të dhënave personale.

Kjo nuk është vetëm një kërkesë ligjore, por një praktikë e domosdoshme për të ndërtuar besimin mes bizneseve dhe qytetarëve.

Të dhënat personale janë një aset i çmuar dhe mbrojtja e tyre duhet të jetë një prioritet për çdo organizatë.

Zyra e Komisionerit mbetet e angazhuar për të lehtësuar dhe mbështetur sa më shumë qytetarët dhe ju si kontrollues e përpunues të të dhënave në zbatimin e detyrimeve të ligjit.

Është shumë e nevojshme që ligji të kuptohet dhe zbatohet në mënyrën e duhur nga të gjithë.

Shfrytëzoj edhe këtë rast, të përsëris se Zyra e Komisionerit ju konsideron një partner, shumë të vlefshëm dhe të aftë, për shkak se kapacitetet tuaja kam besimin se shkojnë përtej një marrëdhënie zbatimi formal të ligjit.

Prandaj dera jonë do të jetë në çdo kohe e hapur dhe zëri i Komisionerit do të jetë gjithnjë në mbështetjen tuaj.

Natyrisht, që kjo marrëdhënie nuk mund të funksionojë në rast të shmangies nga detyrimet e ligjit.

Nuk duhet te harrojmë në asnjë moment, se ky është një ligj që mbron dhe garanton një të drejtë dhe liri themelore të njeriut, prandaj në qendër të vëmendjes së tij është dhe do të mbetet qytetari.

Uroj që bashkëpunimi juaj me Zyrën e Komisionerit do të ndihmojë në garantimin e zbatimit të suksesshëm të ligjit dhe në krijimin e një mjedisi të sigurt dhe të besueshëm për mbrojtjen e të dhënave personale.

Ju faleminderit për kontributin tuaj.